

 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena <b>“UKSHIN HOTI”</b>	
Pranuar me dt.	07.03.2020
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-301A



**UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN**  
**UNIVERSITY “UKSHIN HOTI” PRIZREN**

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000  
 Prizren, Republika e Kosovës;  
 Tel: +381 (0) 29- 232 140;  
 Homepage: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

**RREGULLORE PËR SHTËPINË BOTUESE TË**  
**UNIVERSITETIT TË PRIZRENIT “UKSHIN HOTI”**

Prizren, Nëntor 2019

Bazuar në nenin 4, të Ligjit për veprimtari botuese dhe librin, Nr. 02/L-51, të nenit 25 të Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 04/L-037 dhe në nenin 231, 232, 233, 234 të Statutit të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 31.01.2020, miratoi këtë:

## RREGULLORE PËR SHTËPISË BOTUESE TË UNIVERSITETIT TË PRIZRENIT “UKSHIN HOTI”

### Dispozitat e përgjithshme

#### Neni 1.

1. Me këtë Rregullore përcaktohet baza ligjore për themelimin dhe veprimtarinë e Shtëpisë botuese të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”.
2. Kjo rregullore definon dhe përcakton misionin dhe vizionin, organizimin, procedurat për botim, financimin e botimit, kompetencat dhe detyrat e Shtëpisë Botuese.

#### Neni 2.

Misioni i Shtëpisë botuese të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” është zhvillimi i veprimtarisë botuese, botimin e librave, broshurave, revistave, boletinëve, punimet e kërkuesve shkencorë, mësimdhënësve dhe studentëve, për nxënie të dijes dhe ngritjen e cilësisë në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti”.

#### Neni 3.

Vizioni i Shtëpisë botuese të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” është arritja e rezultateve bazuar në hulumtime dhe kërkime shkencore, hartimi i teksteve universitare me standarde të larta të klasifikimit të informatave në funksion të ngritjes së cilësisë në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti”.

### Organizimi i Shtëpisë Botuese të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”

#### Neni 4.

1. Shtëpia botuese e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” themelohet me vendim të Këshillit Drejtues të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren.
2. Shtëpia botuese e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” është pjesë përbërëse e strukturës organizative të UUHP dhe duhet të funksionojë si njësi e veçantë e paraparë në strukturën organizative (organogramin) e UUHP.
3. Organizimi i Shtëpisë botuese të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” i referohet vendimit të Këshillit Drejtues të UUHP.
4. Shtëpia botuese e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” ka në përbërje të saj, si vijon:
  - a) Këshillin botues;
  - b) Koordinatorin e Shtëpisë botuese;

- c) Një zyrtar teknik (financier).
- d) Librarianë në kuadër të Universitetit
- 5. Koordinatorit caktohet përmes rekrutimit i cili bëhet në përputhje me ligjin përkatës.
- 6. Këshillin botues e zgjedh Senati i UUHP.
- 7. Fushëveprimtaria e Shtëpisë botuese përcaktohet nëpërmjet kësaj rregulloreje

#### Neni 5

1. Shtëpia botuese e Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" zhvillon veprimtarinë e vet si njësi në kuadër të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" e themeluar me vendim të Këshillit Drejtues.

#### Neni 6

1. Rregullorja përcakton standardet dhe kriteret për zhvillimin e veprimtarisë së botuese të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti".

#### Neni 7

1. Shtëpia botuese ka zyren për zhvillimin e veprimtarisë botuese në kuadër të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti".
2. Shtëpia botuese ka një koordinator, i zgjedhur nga Senati, një zyrtar Teknik (financier) i zgjedhur nga Këshilli drejtues.
3. Koordinatori i raporton për punën e tij Këshillit botues dhe Senatit të Universitetit.
4. Zyrtari teknik (financieri) i raporton për punën e tij Këshillit Botues e ky i fundit Këshillit Drejtues të Universitetit.

#### Neni 8

1. Shtëpia Botuese e Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" ka librarinë e vet në kuadër të Universitetit.

#### Neni 9

2. Për veprimtarinë e botuese të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" është përgjegjës Këshilli botues, i cili përbëhet nga përfaqësuesi i rektoratit dhe nga përfaqësuesit e njësive akademike.

#### Neni 10

1. Këshillin botues e zgjedh Senati pas propozimit të Njësive akademike.
2. Këshilli botues ka 5 anëtarë:
  1. Prorektori për mësim, sipas detyrës zyrtare.
  2. Një përfaqësues i Fakultetit të Filologjisë;
  3. Një përfaqësues i Fakultetit Ekonomik;
  4. Një përfaqësues i Fakultetit Juridik;
  5. Një përfaqësues i Fakultetit të Edukimit;
3. Këshilli botues e zgjedh kryetarin nga radhët e veta. Mandati i Këshillit botues është 4 vjet.

4. Anëtarët e Këshillit botues janë edhe redaktorë të publikimeve shkencore nga fusha shkencore, profesionale e artistike të cilës i përkasin.

#### Procedura e botimit të publikimeve

##### Neni 11

1. Veprimtaria e Shtëpisë botuese të UPZ-së përfshin botimin e veprave të propozuara nga Këshilli i Fakultetit dhe botimin e revistës shkencore të Universitetit (Emri i revistës).
2. Botimet përfshijnë veprat për botim në kuadër të veprimtarisë së paraparë në programin e punës të njësive akademike.
3. Botimet e veçanta përfshijnë monografitë, përmbledhjet e kumtesave të konferencave, tryezave shkencore dhe të aktiviteteve të tjera shkencore e artistike.
4. Propozimet për botim i paraqesin njësitë akademike pas procedurave recensuese, i cakton Këshilli botues dhe i miraton Këshilli Drejtues (Senati) i Univeritetit të Prizrenit "Ukshin Hoti".
5. Plani botues i aprovuar nga Këshilli i njësive akademike i dorëzohet Këshillit botues deri në fund të muajit qershor të vitit pararendës.

##### Neni 12

1. Shtëpia Botuese e Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", pas vlerësimit të njësive akademike, boton vepra shkencore dhe artistike të autorëve-profesorëve të vet dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm:
  - 1.1. Boton tekste universitare (deficitare) nga shkencat ekzakte, shkencat shoqërore, nga gjuhësia dhe letërsia dhe nga fusha e arteve;
  - 1.2. Vepra artistike nga letërsia, muzika dhe artet pamore;
  - 1.3. Monografi shkencore dhe artistike;
  - 1.5. Përmbledhje kumtesash nga aktivitetet shkencore e artistike; dhe
  - 1.6. Revista, buletine, vjetarë dhe periodikë të veçantë;
  - 1.7. Përmbledhje të rezultateve të projekteve dhe hulumtimeve shkencore;
2. Shtëpia botuese e Univeritetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" realizon edhe botime që dalin nga bashkëpunimi shkencor dhe artistik me Universitetet e tjera ose me institucionet shkencore e artistike brenda dhe jashtë vendit.

##### Neni 13

1. Shtëpia botuese e UPZ-së boton revistën shkencore të Universitetit 2 herë brenda vitit (31 mars dhe 30 shtator, në çdo 6 muaj).
2. Revista shkencore ka emrin-titullohet nga Senati Universitetit.
3. Revista përfshin punime nga fusha të ndryshme me interes të avancimit të hulumtimeve dhe të arriturave shkencore.
4. Revista përfshin artikuj dhe kontribute të tjera në gjuhësi, letërsi, edukim, ekonomi, juridik, shkenca kompjuterike, shkenca të ambientit dhe jetës, e të tjera punime me interes.

#### Neni 14

1. Botimet e Shtëpisë botuese të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” publikohen në gjuhën shqipe ose në njërën prej gjuhëve botërore (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht).
2. Botimet shqip të Shtëpisë botuese të UPZ-së duhet të kenë rezyme në njërën prej gjuhëve botërore (anglisht, gjermanisht ose frëngjisht), ndërsa botimet në gjuhët e tjera duhet ta kenë rezymenë në gjuhën shqipe, përveç veprave të krijimtarisë artistike.
3. Me vendim të veçantë të njësisë akademike përkatëse të Univeritetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, trajtesat dhe artikujt në revistë botohen edhe në gjuhë të huaja.
4. Studimet dhe artikujt në revistë shkencore duhet të kenë abstraktin dhe rezymenë në njërën nga gjuhët botërore (anglisht, frëngjisht, gjermanisht).
5. Nëse studimi ose artikulli është në gjuhë tjetër, rezymeja hartohet në gjuhën shqipe.
6. Veprat letrare, veprat muzikore, monografite dhe katalogët e arteve pamore shoqërohen me parathënie për veprën dhe autorin.

#### Neni 15

1. Botimet e Shtëpisë botuese të UPZ-së realizohen në formate të standardizuara dhe në teknikat e aprovuara nga Këshilli botues.
2. Këshilli botues me propozimin e njësisë akademike përcakton standardet, teknikat, cilësinë e materialit të shtypit (letrën, lidhjen, etj.).
3. Këshilli botues standardizon formatet e botimeve të Shtëpisë Botuese të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”.
4. Çdo botim i Shtëpisë botuese të UPZ-së duhet të ketë në faqet e fundit shënimet e katalogizimit të Bibliotekës Kombëtare, si dhe numrin ISBN.
5. Revista shkencore e Universitetit të Prizrenit duhet të ketë ISSN.
6. Këshilli Drejtues sipas rekomandimit të Këshillit botues dhe pas propozimit të Këshillit të Njësisë akademike kur është fjala për veprat me recension, miraton tirazhin e çdo botimi të Shtëpisë Botuese të UPZ-së.

#### Neni 16

1. Botimet e Shtëpisë botuese të UPZ-së kanë, në kopertinë, në faqen e parë e të dytë, si dhe në pjesën e sipërme, emrin e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” shqip dhe anglisht, e nën të emrin e njësisë përkatëse akademike, me numrin rendor të botimit.
2. Faqja e parë brenda kopertinave shënohet në gjuhën shqipe, ndërsa e dyta në njërën nga gjuhët e huaja.
3. Në faqet e para të brendshme të çdo botimi vihen emrat e recensentëve, data dhe vendimi i njësisë akademike përkatëse për lejimin e botimit.
4. Në botimet e materialeve të aktiviteteve shkencore në vend të recensentëve shënohen emrat e anëtarëve të Këshillit organizues të aktivitetit përkatës.
5. Në faqen e fundit të botimit shënohen emrat e lektorëve, dizajnit, shtypit dhe shërbimeve të tjera teknike.

6. Nëse botimi realizohet me ndihmën e donacioneve, në njëërën prej faqeve të para të botimit shënohet titulli i donatorit.

#### Neni 17

Në çdo libër të botuar në Shtëpinë botuese duhet të jenë të shënuar dëftuesit e mëposhtëm:

- i. Titulli i veprës;
- ii. Emri i autorit;
- iii. Emri i përkthyesit, hartuesit, përpiluesit;
- iv. Viti i botimit;
- v. Vendi dhe emri i shtypshkronjës;
- vi. Emri i botuesit;
- vii. Numri ndërkombëtar i standardizimit të librit (ISBN);
- viii. Çmimi;
- ix. E drejta e autorit;
- x. Katalogimi në botim (CIP);
- xi. Dëftues të tjerë sipas specifikës së botimit, nëse ka;
- xii. Tirazhi i ekzemplarëve të botuar.

#### Neni 18

1. Dy ose më shumë njësi akademike, në bazë të marrëveshjes, mund të propozojnë botime të përbashkëta.
2. Nëse botimet e përbashkëta realizohen edhe me Universitetin dhe institucionet e tjera, në këto raste emri i Institucionit tjetër shënohet krahas emrit të Universitetit të Prizrenit.
3. Redaksitë e botimeve të përbashkëta i cakton Këshilli Botues pas propozimeve të njëjësive akademike.

#### Neni 19

1. Këshilli i njësisë akademike, pas këshillimit me degën përkatëse i propozon Këshillit botues redaktorët e botimeve përkatëse.
2. Në raste të veçanta Këshilli botues cakton redaksitë për botime.

#### Neni 20

1. Revista shkencore e Universitetit të Prizrenit ka redaksinë, sekretarin e redaksisë (kryetari i Këshillit botues) dhe kryeredaktorin.
2. Redaksia, sekretari dhe kryeredaktori i revistës propozohet nga Këshillat e Fakulteteve dhe zgjedhet nga Senati i Universitetit, me mandat katër vjeçar.
3. Redaksia e revistës duhet ta ketë së paku një anëtar jashtë Universitetit.

#### Neni 21

1. Dorëshkrimet i dorëzohen sekretarit të revistës të përgatitura sipas standardeve:
  - 1.1. Në versionin elektronik, në formatin MS WORD dhe PDF; dhe
  - 1.2. Në letër, 2 kopje.
2. Autori dorëzon dorëshkrimin të pajisur me shtojcat përkatëse (fotografitë, hartat, skicat, grafikët në rezolucionin e përshtatshëm, si dhe tabelat, treguesin e emrave në formatin e caktuar, etj.).
3. Krahas dorëshkrimit autori dorëzon në një rën prej gjuhëve botërore rezymenë për libër, si dhe abstraktet për artikujt shkencorë për revistë.

#### Neni 22

1. Dorëshkrimet i paraqiten sekretarisë së Këshillit të njësish akademike, përmes administratës, në adresë të sekretarit-es, bashkë me deklaratën e autorit se punimi në fjalë, nuk është botuar ose është botuar diku tjetër.
3. Sekretari i Njësish akademike përkatëse në mbledhjet e rregullta të Këshillit paraqet dorëshkrimet e arritura, ku caktohen recensentët.
4. Dorëshkrimet e dorëzuara nuk kthehen.

#### Neni 23

1. Për propozimin e dorëshkrimit për botim nevojitet recension i nënshkruar nga dy recensentë, nga të cilët njëri duhet të jetë anëtar i Këshillit të Fakultetit.
2. Në raste të veçanta për propozimin e dorëshkrimit për botim shkruhen dy recensione.
3. Nëse ndër anëtarët e Këshillit të Fakultetit nuk ka specialistë për fushën e caktuar, atëherë caktohen recensentë të jashtëm të fushave përkatëse.

#### Neni 24

1. Vendimi rreth dorëshkrimit merret nga Këshilli i Fakultetit përkatës në bazë të vlerësimit të recensentëve.
2. Vendimet e Këshillit të Fakultetit janë:
  - 2.1. Dorëshkrimi miratohet për botim;
  - 2.2. Dorëshkrimi i kthehet autorit që të plotësohet sipas vërejtjeve të recensentëve; dhe
  - 2.3. Dorëshkrimi refuzohet.

#### Neni 25

1. Dorëshkrimet e kompletuara për botim sipas Nenit 18 paragrafi 1 dhe 19 nënparagrafi 2.1 i shtrohen lekturës, nëse Këshilli nuk vendos ndryshe.
2. Caktimi i lektorit bëhet me vendim të Këshillit të Fakultetit (Senatit të Universitetit).
3. Për ndërhyrjet në dorëshkrim autori njoftohet nëpërmjet sekretarit të Fakultetit përkatës.

#### Neni 26

1. Dorëshkrimet e përgatitura për botim dorëzohen nga sekretarët e njësive akademike te kryetari-Sekretari i Këshillit botues, i cili i procedon te Këshilli drejtues (Senat).
2. Dorëshkrimet e aprovuara për botim, pjesë e programeve të punës të Këshillit të Fakultetit, dërgohen në shtyp në kufijtë e afateve kohore që i cakton Këshilli botues.
3. Lejen për shtyp e nënshkruan kryesuesi i Këshillit botues.

#### Neni 27

1. Dorëshkrimi dorëzohet në shtyp pasi të lidhen kontratat sipas kushteve të parapara me këtë Rregullore.
2. Në kontratë, përveç të tjerash, përfshihen këto elemente:
  - 2.1. Emri dhe adresa e kontraktuesve;
  - 2.2. Titulli i veprës që botohet;
  - 2.3. Vëllimi i veprës në tabakë autori, respektivisht numri i faqeve;
  - 2.4. Regjistri i shtojcave;
  - 2.5. Shuma, mënyra dhe afatet e pagesës së honorarit të autorit;
  - 2.6. Tirazhi; dhe
  - 2.7. Numri i ekzemplarëve që i jepen autorit pa kompensim.
3. Kontratën, në emër të Universitetit, e nënshkruan sekretari shkencor i Akademisë.
4. Universiteti nuk obligohet lidhur me afatin për shtypjen e dorëshkrimit.

#### Neni 28

1. Autori i dorëshkrimit të botuar nuk ka të drejtë të kërkojë ribotimin e dorëshkrimit tek një botues tjetër pa marrëveshje me Universitetin.
2. Këshilli Drejtues i Universitetit, në raste të veçanta, me vendim të Këshillit Botues, lejon ribotimin ose shtimin e tirazhit të botimeve të saj.

#### Neni 29

1. Shtëpia botuese e Universiteti nuk i boton dorëshkrimet që janë botuar në tërësi te një botues tjetër, përveç prezantimeve në projekte të veçanta.
2. Dorëshkrimet e reja nuk merren në konsideratë për botim nëse më parë janë botuar më shumë se 25% e tekstit të dorëshkrimit.
3. Shtëpia botuese përfshin në planin e vet botues botimet shkencore dhe tekstet universitare, revistat dhe botime të tjera të veçanta.

#### Neni 30

##### Financimi i botimit të publikimeve

1. Vlerësimi i publikimeve shprehet në valutë (Euro) dhe për bazë merret numri i faqeve të tekstit të botuar.
2. Caktimi i pikëve bëhet sin ë vijim:
  - 2.1. Për redaktor 1 E në faqe;



- 2.2.Për recensentë 2 E në faqe (shuma pjesëtohet me numrin e recensentëve);
- 2.3.Për lekturë dhe korrekturë 1.5 Euro për faqe;
- 2.4.Për autorin/autorë 1500 E nga 70 -99 faqe; 2500 E nga 100-250 faqe; 2500+5(X-250 faqe) ku X është numri i faqeve të tekstit);
3. Për përmbledhje detyrash, praktikume:
- 3.1. 1000 E nga 70-99 faqe; 1500 E nga 100-250 faqe; 1500+5(X-250 faqe) ku X është numri i faqeve të tekstit);
4. Për përkthim të tekstit honorari është 10 Euro për 1 faqe.
5. Honorari për botimin e dytë është 50% i honorarit të botimit të parë të autorit/autorëve të njëjtë.
6. Honorari për botimin e tretë është 30% i honorarit të botimit të parë të autorit/autorëve të njëjtë.
7. Për botimin e dytë e tutje kompenzohet vetëm autori/autorët.
8. Vendimin për përkthim sipas kërkesave e merr Këshilli botues.
9. Rektorati i Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” e kompenson autorin/autorët edhe me 50% të mjeteve të realizuara nga shitja e publikimit.
10. Nëse shpenzimet e publikimit i ka mbuluar autori, 80% të mjeteve të realizuara i/u shkojnë autorit/autorëve dhe 20% i takojnë Universitetit.
11. Nga çmimi kushtues i shitjes i takon:
- 11.1. Universitetit 85% nga çmimi i shitjes së publikimit;
- 11.2. Rrjetit të shitjes 15% nga çmimi i shitjes;
- 11.3. Nga momenti i themelimit të Librarisë shitja bëhet vetëm në librarinë e Universitetit;
- 11.4. Mjetet i kthehen Rektoratit sipas dinamikës e shitjes së publikimeve;
- 11.5. Në cilëndo mënyrë të financimit të publikimeve, çmimi i shitjes dhe vendi i shitjes caktohen në mënyrë të njëjtë. Autori/autorët nuk kanë të drejtë ta shesin vetë librin dhe as ta imponojnë te studentët.
12. Financimi i publikimeve bëhet me mjetet e buxhetit të Universitetit dhe me mjete të tjera (sponsorë, donatorë, nga grumbullimi i mjeteve të shitjes së publikimeve, nga vetë autori/autorët). Mjetet grumbullohen në konto të veçantë dhe përkrahen botimet e publikimeve.
13. Çmimi i shitjes së publikimit për botim llogaritet sipas shumës së mjeteve financiare 0.015 E për faqe të tekstit të botuar.
14. Çmimet dhe obligimet e tjera mes botuesit, autorit dhe subjekteve të tjera të parapara me këtë Rregullore përcaktohen me kontratë.
15. Përgjegjës për mjetet financiare lidhur me botimin është Prorektori për Financa.
16. Çdo publikim që nuk ka kaluar në procedura sipas kësaj Rregulloreje konsiderohet publikim pa leje dhe ndaj shkelësve merren masa ligjore.

#### Neni 31

1. Shtëpia botuese e UPZ-së i këmben, i jep pa kompensim ose i shet botimet e veta.
2. Shtëpia botuese e UPZ-së botimet e veta i këmben me institucionet shkencore, universitetet, fakultetet dhe organizatat e tjera shkencore-kulturore brenda dhe jashtë vendit.
3. Këmbimi bëhet sipas parimit, të gjitha botimet e Shtëpisë botuese me të gjitha botimet e institucioneve të tjera, libër me libër, pa pasur parasysh vlerën e tyre, ose libër me libër, sipas vlerës.
4. Këmbimet realizohen në bazë të marrëveshjeve paraprake të përfaqësuesve të institucioneve.

#### Neni 32

1. UPZ ua ndan pa kompensim nga një kopje të çdo botimi:
  - 1.1. Të gjithë profesorëve të njësisë nga vjen autori, nëse vjen nga Fakulteti përkatës; Rektoratit të Universitetit, Këshillit Drejtues, Dekanëve dhe Fakulteteve.
  - 1.2. 10 kopje Bibliotekës së Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti".
  - 1.3. 3 kopje Ministrisë së Arsimit, të Shkencës e Teknologjisë;
  - 1.4. 3 kopje Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sporteve;
  - 1.5. 3 kopje Bibliotekës Universitare të Kosovës;
  - 1.6. 3 kopje Bibliotekës Kombëtare të Kosovës sipas ligjit në fuqi;
  - 1.7. 3 kopje Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë;
  - 1.8. 2 kopje Bibliotekës së Institutit Albanologjik të Prishtinës;
  - 1.9. 2 kopje Bibliotekës së Institutit të Historisë të Kosovës dhe
  - 1.10. 2 kopje Bibliotekave përkatëse të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës.
3. Me kërkesën e institucioneve ose të individëve të interesuar, me lejim të Këshillit botues mund të jepen pa kompensim botimet e Shtëpisë botuese.
4. Këtyre botimeve u vihet vula "Dhuratë" e Shtëpisë Botuese të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti".

#### Neni 33

1. Autorit dhe bashkautorit të botimeve u takojnë pa kompensim gjithsej 30 kopje.
2. Autorit dhe bashkautorit të punimeve të botimeve të përbashkëta (konferenca, tryeza dhe aktivitete të tjera shkencore) u takon nga një kopje pa kompensim.
3. Redaktorit, recensentëve, lektorëve, shërbimeve të dizajnit dhe shërbimeve të tjera teknike u takon nga një kopje e botimit.

#### Neni 34

1. Botimet e Shtëpisë botuese shiten në Librarinë e Universitetit dhe në forma të tjera legale.
2. Çmimet e shitjes i cakton Këshilli botues të aprovuara nga Këshilli drejtues.
3. Librarive u lejohet marzha e rëndomtë ose e kontraktuar.
4. Botimet e Shtëpisë botuese të UPZ-së në raste të veçanta shiten edhe me ulje të çmimit deri në 50%.

Neni 35

1. Në arkivin e Universitetit ruhen nga pesë kopje të çdo botimi.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 36

1. Për zbatimin e drejtë të kësaj Rregulloreje kujdeset Kryetari i Këshillit botues.
2. Interpretimin autentik të kësaj Rregulloreje e jep miratuesi.

Neni 37

1. Plotësimi dhe ndryshimi i kësaj rregulloreje bëhet sipas procedurës së miratimit.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti".

Prof. Asoc. Dr. Bedri Mubadi



Kryesues i Këshillit Drejtues